



Republika e Kosovës • Republika Kosovo • Republic of Kosovo
Institucioni i Avokatit të Popullit • Institucija Ombudsmena • Ombudsperson Institution

RAPORT

I

AVOKATIT TË POPULLIT

R. nr. 1326/2024

në lidhje me ndikimin negativ të mbeturinave komunale në jetën private të qytetarëve

Drejtuar: Z. Përparim Rama, kryetar
Komuna e Prishtinës

Prishtinë, më 23 korrik 2025

Qëllimi i Raportit

Ky Raport me Rekomandime ka për qëllim adresimin e shqetësimit të qytetarëve, përkitazi me ndotjen e mjedisit dhe të ajrit nga operimi i kontejnerëve të mbeturinave komunale, të vendosur në afërsi të banesës së qytetarëve në rrugën “Afrim Loxha” 3/1 në Prishtinë.

Raporti synon t’i sjellë në vëmendje të drejtat themelore të qytetarëve për gëzimin e jetesës cilësore në një mjedisi të pastër, të sigurt dhe të shëndetshëm, si dhe pasqyron qëndrimet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit përkitazi me detyrimet pozitive të shtetit për të vepruar drejt një zgjidhjeje të qëndrueshme të menaxhimit të mbeturinave.

Ky Raport është i bazuar në ankesën individuale të z. Nexhat Xharrës, parashtruar në Institucionin e Avokatit të Popullit, nga informatat që kemi marrë nga Komuna e Prishtinës si dhe në të dhënat e raportit të Institutit Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK), të datës 28 mars 2025, mbi vlerësimin e rrezikut të aerondotjes dhe kundërmimit nga grumbullimi i mbeturinave komunale në afërsi të banesave të banimit në adresën rr. “Afrim Loxha” 3/1, në Prishtinë.

Baza ligjore e Avokatit të Popullit

Sipas Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit, Avokati i Popullit, ndër të tjerash, ka këto kompetenca dhe përgjegjësi:

- *“Për t’i hetuar ankesat e pranuar nga çdo person fizik a juridik lidhur me pohimet për shkeljen e të drejtave të njeriut të parapara me Kushtetutë, ligje dhe akte tjera, si dhe me instrumente ndërkombëtare të të drejtave të njeriut, veçanërisht me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke përfshirë veprimet apo mosveprimet që paraqesin keqpërdorim të autoritetit.” (neni 16, paragrafi 1).*
- *“Të tërheqë vëmendjen për rastet kur autoritetet i shkelin të drejtat e njeriut dhe të bëjë rekomandim që t’u jepet fund rasteve të tilla dhe kur është e domosdoshme të shprehë mendimin e vet mbi qëndrimet dhe reagimet e autoriteteve përkatëse në lidhje me rastet e tilla.” (neni 18, paragrafi 1, nënparagrafi 1.2).*

Përmbledhja e fakteve dhe veprimet e Avokatit të Popullit

1. Avokati i Popullit, në bazë të nenit 16, paragrafi 1, të Ligjit nr.05/L-019 për Avokatin e Popullit, më 31 dhjetor 2024 ka pranuar ankesën e z. Nexhat Xharrës, parashtruar kundër Komunës së Prishtinës për mospërgjigje në kërkesë. Sipas pohimeve të ankuesit dhe të dokumentacionit që ka dorëzuar në Institucionin e Avokatit të Popullit (IAP), z. Xharra më 12 gusht 2024 i është drejtuar Komunës së Prishtinës, përkatësisht Drejtorisë së Shërbimeve Publike, Mbrojtjes dhe Shpëtimit, me Kërkesë nr.07-352/13-105168/24, për largimin e 5 kontejnerëve të mbeturinave, të vendosur nga Komuna e Prishtinës pranë banesës në të cilën jeton, në adresën rr. “Afrim Loxha”, 3/1, në Prishtinë. Sipas pohimeve të ankuesit, kontejnerët e vendosur pranë banesës së tij kanë vështirësuar jetesën e tij dhe të familjes së tij nga kundërmimi dhe ndotja e ajrit. Po ashtu, gjendja e krijuar, sipas pretendimeve të z. Xharrës, ka bërë të pamundur ajrosjen natyrore nëpërmjet dritareve të banesës. Ankuesi ka pohuar se deri në kohën e parashtrimit të ankesës në IAP, nuk ka marrë përgjigje nga Komuna e Prishtinës në kërkesën e tij.
2. Më 1 shkurt 2025 Avokati i Popullit i është drejtuar me shkresë kryetarit të Komunës së Prishtinës, me të cilën i ka kërkuar informata për veprimet të cilat Komuna e Prishtinës i

ka ndërmarrë apo për ato që planifikonte t'i ndërmerre, përkitazi me çështjen e ngritur nga ankuesi.

3. Më 18 mars 2025 Avokati i Popullit pranoi përgjigje nga kryetari i Komunës së Prishtinës, nëpërmjet së cilës u informua për përgjigjen të cilën Komuna e Prishtinës më 23 dhjetor 2024 ia ka adresuar ankuesit. Në përgjigjen drejtuar ankuesit, udhëheqësi i Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimeve Publike, ka potencuar se pas shqyrtimit të kërkesës së z. Xharrës, pavarësisht gatishmërisë për ta ndihmuar, një gjë e tillë është e pamundur meqë kontejnerët i përkasin bllokut banesor dhe lokacioni në të cilin janë vendosur është më i përshtatshëm për vendosjen e kontejnerëve.
4. Më 20 mars 2025, duke u bazuar në rrethanat e rastit, përfaqësuesja e IAP-së, përmes postës elektronike i është drejtuar me kërkesë IKShPK-së, që në bazë të kompetencave të përcaktuara me Ligjin nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, sipas së cilit: *“IKSHPK hulumton ndikimin e faktorëve mjedisor në shëndetin e popullsisë, propozon dhe ndërmerr veprime profesionale dhe u rekomandon institucioneve kompetente eliminimin e mangësive të zbuluara dhe çfarëdo efekti të dëmshëm për shëndet”*, ta vlerësojë ndikimin në mjedis dhe shëndetin e banorëve të objektit në rrugën “Afrim Loxha” 3/1, në Prishtinë nga kontejnerët e vendosur në afërsi të vendbanimeve të tyre.
5. Më 28 mars 2025 Avokati i Popullit ka marrë përgjigje nga IKShPK-ja, e cila nëpërmjet raportit nga inspektimi i vendit të ngjarjes, i realizuar më 26 mars 2025, ka evidentuar të gjeturat si në vijim:

“Gjetjet në terren janë:

- *Në 5 kontejnerët e kësaj lagjeje zbrazeshin mbeturinat edhe të lagjeve tjera si nga Taslixhja, Kacallarët, Kolovica, Sofalia, çerdhja publike, dhe qebaptoret pranë.*
 - *Në afërsi të kontejnerëve është një park lodrash i fëmijëve dhe gjatë ditëve të ngrohta ka erë kundërmuese, insekte, brejtës, mace dhe qenë.*
 - *Rreth kontejnerëve është hedhur hiri i bizneseve dhe mbetjet inerte, të cilat kompania "Pastrimi" nuk i merr.*
 - *Banorët na i treguan incizimet se shpesh mbeturinave në kontejner ju vihet edhe zjarri.*
 - *Në momentin e vizitës takuam personelin e çerdhes duke hedhur mbeturinat e fëmijëve (ushqime të mbetura, pampersë, dyshekë të lagur) po në të njëjtit kontejner, pasi vet objekti parashkollor nuk posedonte kontejnerët vetanak për eliminimin e mbeturinave.”*
6. Bazuar në të gjeturat në terren, IKShPK-ja ka vlerësuar efektet shëndetësore si pasojë e ekspozimit ndaj mbeturinave. Vlerësimet e IKShPK-së evidentohen në vijim:
 - *Dispozicioni jo i drejtë i mbeturinave urbane ndikon në ndotjen e tokës, ujit dhe ajrit. Efektet shëndetësore, karshi ekspozimit ndaj mbeturinave, janë:*
 - *Rrezik potencial për shëndetin e punëtorëve të cilët manipulojnë me mbeturina.*
 - *Rrezik potencial për banorët me që mbeturinat janë terren i përshtatshëm për rritjen dhe shumëzimin e insekteve dhe brejtësve, që shërbejnë si vektor për bartjen e sëmundje të ndryshme ngjitëse.*
 - *Rrezik potencial për sulm nga qentë dhe macet endacake, të cilat kërkojnë ushqim nga mbeturinat përreth kontejnerëve.*

- Qentë dhe macet endacake bëjnë shpërndarjen e mbeturinave që përsëri rritë rrezikun për sëmundje ngjitëse.
 - Prezenca e qenve dhe maceve endacake potencialisht rritë nivelin e zhurmës në lagje. Rrezik potencial nga lëndimet mekanike (xhamat, gjësendet me tehe dhe maje) të cilat gjinden në mbeturinat rreth kontejnerëve, posaçërisht për fëmijët të cilët lozin në parkun pranë mbeturinave si dhe për personat që grumbullojnë mbeturina të riciklueshme.
 - Rrezik potencial për fëmijët që lozin në parkun e lodrave pranë, për shkak të gjërave të cekura më lartë.
 - Kapakët e kontejnerëve janë të hapura dhe i nënshtrohen kushteve. klimatike.
 - Aroma e pakëndshme e mbeturinave, gjithherë është e pranishme.
 - Ndezja e kontejnerëve ndikon edhe më shumë cilësinë e ajrit.
7. Bazuar në të gjeturat në terren dhe vlerësimet, IKShPK-ja ka paraqitur rekomandimet për Komunën e Prishtinës, të cilat pasqyrohen në pjesën e fundit të raportit.

Baza ligjore

Dispozitat e Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe të Konventës Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut, për rastin konkret

Kushtetuta e Republikës së Kosovës

Neni 7 [Vlerat]

“1. Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet e lirisë, të paqes, të demokracisë, të barazisë, të respektimit të të drejtave dhe të lirive të njeriut dhe të sundimit të ligjit, të mosdiskriminimit, të së drejtës së pronës, të mbrojtjes së mjedisit [...].”

Neni 21 [Parimet e Përgjithshme]

“1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të pacenueshme dhe janë bazë e rendit juridik të Republikës së Kosovës.

2.Republika e Kosovës mbron dhe garanton të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, të parashikuara në këtë Kushtetutë. [...].”

Neni 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor]

“1. Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.

2. Institucionet e pushtetit publik angazhohen për t'i garantuar secilit mundësinë që të ndikojë në vendimet që kanë të bëjnë me mjedisin jetësor ku ajo/ai jeton.

3. Ndikimi në mjedisin jetësor merret parasysh nga institucionet publike në procesin e marrjes së vendimeve.”

Neni 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut]

“Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.”

Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut dhe Protokollet e saj

Neni 13 [E drejta për zgjidhje efektive]

“Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.”

Neni 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare]

“1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrrespondencës së tij. [...]”

Analiza ligjore

8. Vlerësimet, konkluzionet dhe konstatimet e Avokatit të Popullit përkitazi me rastin R.nr.1326/2024 bazohen në të drejtat e garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, me ligjet relevante të zbatueshme në vend, me Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNJ) dhe me praktikën e Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (GjEDNJ).
9. , mbrojtjen e mjedisit jetësor, përveçqë e garanton në Kapitullin II [Të Drejtat dhe Lirit Themelore], mjedisin dhe mbrojtjen e tij e rendit në mesin e vlerave të rendit kushtetues, i cili në nenin 7 [Vlerat] përcakton si në vijim: “1.Rendi kushtetues i Republikës së Kosovës bazohet në parimet ..., respektimit të të drejtave dhe lirive të njeriut dhe sundimit të ligjit, mosdiskriminimit, të drejtës së pronës, **mbrojtjes e mjedisit** [...]”
10. Për më tepër, Kushtetuta përgjegjësinë për mjedisin jetësor e përcakton me nenin 52 [Përgjegjësia për Mjedisin Jetësor], i cili në paragrafin 1 shprehimisht specifikon: “*Natyra dhe biodiversiteti, mjedisi jetësor dhe trashëgimia kombëtare, janë përgjegjësi për secilin.*” Ky nen, pjesë e rëndësishme e kuadrit juridik, përcakton përgjegjësinë e shtetit dhe të gjithsecilit për ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve për një mjedis të pastër dhe të shëndetshëm.
11. Respektimi i jetës private dhe familjare garantohet me Nenin 36, të Kushtetutës, [E Drejta e Privatësisë] “1. Çdokush gëzon të drejtën që t’i respektohet jeta private dhe familjare...”
12. E drejta për mjedis, ajër të pastër dhe të shëndetshëm dhe mbrojtja e shëndetit mbrohen jo vetëm me Kushtetutë, por edhe me standardet ndërkombëtare të zbatueshme drejtpërsëdrejti në Kosovë, dhe veçanërisht me praktikën gjyqësore të GjEDNJ-së.
13. Konkretizimi i dispozitave kushtetuese, për zhvillimin e qëndrueshëm dhe mbrojtjen e mjedisit jetësor, konkretisht për mbrojtjen e ajrit nga ndotja si dhe mbrojtjen e shëndetit publik si pasojë e ndotjes së ajrit, përfshirë përgjegjësitë dhe obligimet ligjore të autoriteteve publike, rregullohen me ligjet përkatëse në fuqi, si në vijim:
 - Ligji Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, neni 2 - Dispozitat e përgjithshme [...]: “1. Ky ligj rregullon sistemin e integruar për mbrojtjen e mjedisit, zvogëlimin e rrezikut për ndotjen e mjedisit, jetën dhe shëndetin e njeriut sipas konceptit të zhvillimit të qëndrueshëm.”
 - Ligji Nr. 08/L-025 për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja, neni 1 [Qëllimi]: “1. Ky ligj ka për qëllim të përcaktojë kompetencat dhe përgjegjësitë e institucioneve për të siguruar të drejtën e qytetarëve për të jetuar në një mjedis me ajër të pastër, duke mbrojtur shëndetin e njeriut, faunën, florën dhe vlerat natyrore e kulturore të mjedisit nga ndotja e ajrit.”

- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, në nenin 17 [Kompetencat Vetanake], saktësisht potencon: “Komunat kanë kompetenca të plota dhe ekskluzive, për sa i përket interesit lokal, duke i respektuar standardet e përcaktuara në legjislacionin e zbatueshëm, në fushat që vijnë: [...] e) mbrojtjen e mjedisit lokal; f) ofrimin dhe mirëmbajtjen e shërbimeve publike dhe shërbimeve komunale, përfshirë menaxhimin e mbeturinave; i) promovimin dhe mbrojtjen e të drejtave të njeriut; m) shëndetësinë publike; p) ofrimin dhe mirëmbajtjen e parqeve dhe hapësirës publike; [...].”
- Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, decidivisht në nenin 1 saktëson: “Ky ligj ka për qëllim: [...] 1.4. parandalimi i ndikimeve negative të mbeturinave në mjedis dhe shëndetin e njeriut.” Neni 2 [Fushëveprimi] i ligjit rregullon menaxhimin e mbeturinave, planet për menaxhimin e mjedisit, të drejtat dhe detyrimet e personave të licencuar të cilët merren me menaxhimin e mbeturinave, mënyra dhe kushtet e mbledhjes së mbeturinave, transportit, trajtimit [...]. Neni 15 [Përgjegjësitë dhe detyrat e komunës]: “1. Përgjegjësitë dhe detyrimet e komunës për zbatimin e dispozitave të këtij ligji janë: [...] 1.1. krijimi i sistemit për menaxhimin e mbeturinave bazuar sipas parimit të hierarkisë për a menaxhimin e mbeturinave për territorin e tyre, hartimi i planit lokal të veprimit për menaxhimin e mbeturinave, sipas nenit 10 të këtij ligji dhe krijimi i kushteve për zbatimin e tij. [...] 1.3. përgjegjës për zbatimin e planeve komunale janë Komunitat; [...] 1.9. evidentimi i vendeve të ndotura në territorin e tyre, hartimi i projekteve për sanimin e tyre me shënime për lokacionin, karakteristikat hapësinore gjeometrike, lloji i ndotjes, sasia e mbeturinave, afatet për përmirësimin e gjendjes dhe shënime të tjera me rëndësi për realizimin e projekteve. [...] 3. Komuna ushtron mbikëqyrjen dhe kontrollin e masave dhe veprimeve gjatë menaxhimit të mbeturinave në territorin e vet, përmes inspektorit komunal për mjedis. [...] 5. Komuna është e detyruar të sigurojë largimin dhe përkujdesjen e mbeturinave të cilat janë hedhur në hapësira publike ose jashtë deponive të mbeturinave në territorin e saj. 6. Nëse personi përgjegjës për menaxhimin e mbeturinave në pajtim me përgjegjësitë ligjore nuk përkujdeset për mbeturinat e hedhura nga personi i pa njohur, përgjegjësinë për ato mbeturina e bartë komuna. [...]” Neni 22 [Organizimi i menaxhimit të mbeturinave]: 1. Menaxhimi i mbeturinave organizohet në atë mënyrë që mos të paraqiten dëme dhe rreziqe për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, në pajtim me këtë ligj.[...]”
- Ligji Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike, Neni 1 [Definimi i termave të përdorur në Ligj]: [...] p) Ndotja: ndryshimet jonormale të padëshirueshme në karakteristikat fizike, kimike, biologjike të ujit, **ajrit**, tokës dhe ushqimit që ndikojnë apo mund të ndikojnë negativisht në shëndetin e njeriut dhe organizmave tjerë të gjallë.[...]” Neni 4, pika 4.2: “Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike të Kosovës(IKSHPK) është institucion publik i cili ushtron veprimtari referente në lëmin e shëndetësisë publike si në vijim: [...] I) Analizimit dhe vlerësimit të aerondotjes; [...]” Neni 8: “IKSHPK hulumton shkaqet dhe pasojat e aerondotjes që dëmtojnë shëndetin publik si dhe i propozon masat mbrojtëse. [...]”

14. Në kuadër të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, shtetet janë të detyruara të krijojnë kushte që sigurojnë të drejtat themelore, përfshirë të drejtën për një mjedis të shëndetshëm dhe të drejtën për shëndet. Ky detyrim është evidentuar në praktikën

gjyqësore të GjEDNj-së, e cila e ka interpretuar këtë detyrim si një “detyrim pozitiv” që shteti duhet ta realizojë për ta mbrojtur jetën dhe mirëqenien e individëve.

15. Avokati i Popullit, duke u bazuar në nenin 53 [*Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut*] të Kushtetutës, sipas të cilit: “*Të drejtat njeriut dhe liritë themelore të garantuara në Kushtetutë interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut.*”, në vazhdim sjell në vëmendje praktikën e GjEDNj-së ku gjykata, nëpërmjet praktikës së saj, mbrojtjen e mjedisit dhe të drejtën mjedisore e ka interpretuar në frymën e Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (KEDNj), në nenin 2 [E drejta për jetën] dhe në nenin 8 [E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare].
16. Avokati i Popullit, lidhur me mosarritjen e organeve kompetente për të përmbushur obligimet e tyre për menaxhimin e mbeturinave, sjell në vëmendje rastin *Di Sarno dhe të tjerët kundër Italisë* (2012), që ka të bëjë me ndotjen dhe shqetësimet e qytetarëve të shkaktuara nga menaxhimi i dobët i shërbimeve të grumbullimit, trajtimit dhe depozitimit të mbetjeve në rajonin e Campania-s të Italisë. Në këtë rast ku gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 8 të Konventës, vuri në dukje se shteti ka qenë i detyruar të miratonte masa të arsyeshme dhe të përshtatshme për ta përmbushur të drejtën e individëve për një mjedis të shëndetshëm dhe të mbrojtur, pasi efektet e keqmenaxhimit dhe dëmi mjedisor kanë ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien personale të banorëve.
17. Rëndësia e së drejtës së qytetarëve për të gëzuar një mjedis të shëndetshëm theksohet në rastin *Băcilă kundër Rumanisë* (2010), ku gjykata ka theksuar: “[...] *Ekzistenca e pasojave të rënda dhe të vërtetuara për shëndetin e popullatës përbën një detyrim pozitiv për shtetin për të miratuar dhe zbatuar masat e arsyeshme dhe adekuate të afta për të mbrojtur mirëqenien e tyre.*” Ndërsa në rastin *Öneryıldız kundër Turqisë* (2004), gjykata ka trajtuar obligimin e marrjes së masave operacionale nga shteti kur dihej ose duhej ta dinin ekzistencën e një rreziku të tillë. (shih Opinionin A.nr.173/2021 të Avokatit të Popullit, paragrafi 55).
18. E drejta për zgjidhje efektive po ashtu garantohet me nenin 13 të KEDNj-së, i cili përcakton: “*Çdokush, të cilit i janë shkelur të drejtat dhe liritë e përcaktuara në këtë Konventë, ka të drejtën e një zgjidhjeje efektive para një organi kombëtar, pavarësisht se shkelja është kryer nga persona që veprojnë në përmbushje të funksioneve të tyre zyrtare.*” Kjo dispozitë nënkupton që individët të cilët besojnë se të drejtat e tyre janë cenuar apo shkelur duhet ta kenë mundësinë të kërkojnë një zgjidhje efektive te një organ nacional, pavarësisht se kush është përgjegjës për shkeljen, përfshirë zyrtarët.
19. Përkitazi me të drejtën për zgjidhje efektive, Avokati i Popullit gjen se në rastin *Cordella dhe të tjerët kundër Italisë* (2019), gjykata ka konstatuar shkelje të nenit 8 dhe shkelje të nenit 13 të Konventës, sepse, sipas gjykatës, vazhdimësia e një situate të ndotjes së mjedisit rrezikonte shëndetin e ankuesve dhe në përgjithësi shëndetin e gjithë popullsisë që jetonin në zonat në rrezik. Gjykata ishte shprehur se autoritetet nacionale nuk i kanë ndërmarrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar mbrojtje efektive të së drejtës së ankuesve për respektimin e jetës së tyre private dhe ka vlerësuar se ankuesit nuk e kishin në dispozicion një mjet juridik efektiv që do t’ua mundësonte adresimin e ankesës tek autoritetet nacionale kompetente dhe të merrnin një zgjidhje efektive nga kjo e fundit.

Zbatimi i parimeve të mësipërme në rastin konkret

20. Në kontekstin e analizimit të meritave të rastit konkret, Avokati i Popullit fillimisht vë në pah se thelbi i kontestit në këtë rast është i) ndikimi negativ i mbeturinave komunale në jetën private të ankuesit dhe të banorëve të tjerë, si pasojë e afërsisë me banesat e tyre, ii) menaxhimi jo i duhur i mbeturinave komunale, iii) ndikimi i mundshëm negativ në shëndetin e banorëve si dhe iv) dështimi i gjetjes së një zgjidhjeje efektive nga komuna, pas kërkesës përkatëse nga ankuesi.
21. Sipas bazës ligjore të theksuar më sipër, menaxhimi i mbeturinave komunale është përgjegjësi ekskluzive e komunës, në rastin konkret është përgjegjësi e Komunës së Prishtinës. Përgjegjësitë përgjegjëse dhe detyrimeve të tjera të komunës, obligimi ligjor primar i menaxhimit të mbeturinave komunale është krijimi i një sistemi që qëndrueshëm të mbeturinave duke e parandaluar ndikimin negativ të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut. Në paragrafin 1 të nenit 22 [Organizimi i menaxhimit të mbeturinave], Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina shprehimisht përcakton: “*Menaxhimi i mbeturinave organizohet në atë mënyrë që mos të paraqiten dëme dhe rreziqe për mjedisin dhe shëndetin e njeriut, në pajtim me këtë ligj.[...].*”
22. Avokati i Popullit ka vërejtur se ankuesi i ishte drejtuar Komunës së Prishtinës me kërkesë, nëpërmjet së cilës e ka njoftuar atë për gjendjen e shkaktuar nga operimi i 5 kontejnerëve të mbeturinave të vendosur nga komuna në afërsi të banesës së tij, si dhe i ka kërkuar komunës zhvendosjen e kontejnerëve në një vend më të përshtatshëm, që nuk do të përbënte pengesë për banorët. Për më tepër, ankuesi e kishte njoftuar komunën mbi ndikimin negativ të mbeturinave në jetën private të banorëve nga lirimi i kundërmimit të tyre dhe ndotja e ambientit si pasojë e hedhjes së tyre në mënyra të pa klasifikuara dhe të ekspozuara si dhe mbetjeve të tyre edhe jashtë kontejnerëve, të cilat jo rregullisht ishin pastruar nga kompania përkatëse.
23. Në përgjigjen të cilën Komuna e Prishtinës ia kishte kthyer ankuesit, komuna kishte theksuar se e kishte të pa pamundur zhvendosjen e kontejnerëve, pasi i përkasin bllokut banesor dhe lokacioni aktual është më i përshtatshëm për vendosjen e tyre. Përgjigjja e komunës nuk përmbante ndonjë arsyetim për refuzimin e kërkesës së ankuesit. Pamundësia e theksuar nga komuna, për mënjanimin e pengesës nga mbeturinat komunale për banorët e lagjes nuk kishte asnjë justifikim të qëndrueshëm.
24. Rrjedhimisht, edhe pse ankuesi e kishte pasur mundësinë t’i drejtohej autoritetit kompetent për adresimin e shqetësimeve, megjithatë komuna, duke mos mëtuar për ta vlerësuar gjendjen, nuk kishte ofruar asnjë justifikim të qëndrueshëm dhe nuk e kishte ndërmarrë asnjë veprim për ofrimin e një zgjidhjeje efektive kundrejt shqetësimit të banorëve. Në rrethana të ngjashme, GjEDNj-së në rastin *Cordella dhe të tjerët kundër Italisë (2019)* kishte konstatuar shkelje të nenit 13 të KEDNj-së, pasi individët nuk kishin pasur mundësi të merrnin një zgjidhje të efektshme në nivel nacional.
25. Duke marrë parasysh ndikimin negativ të ndotjes së ajrit në shëndetin e njeriut, sipas kërkesës së Avokatit të Popullit, IKShPK-ja më 26 mars 2025 realizoi vlerësimin e ndikimit të mundshëm të gjendjes së mbeturinave në shëndetin e banorëve në adresën përkatëse, si pasojë e afërsisë së mbeturinave me banesat e banorëve. Në raportin e IKShPK-së drejtuar Avokatit të Popullit më 28 mars 2025, nga inspektimi i vendit të ngjarjes, gjendja është vlerësuar si vijon: “*Në 5 kontejnerët e kësaj lagjeje zbrazeshin mbeturinat edhe të lagjeve tjera si nga Taslixhja, Kacallarët, Kolovica, Sofalia, çerdhja*

publike, dhe qebaptoret pranë. Në afërsi të kontejnerëve është një park lodrash i fëmijëve dhe gjatë ditëve të ngrohta ka erë kundërmuese, insekte, brejtës, mace dhe qenë. Rreth kontejnerëve është hedhur hiri i bizneseve dhe mbetjet inerte, të cilat kompania "Pastrimi" nuk i merr. Banorët na i treguan incizimet se shpesh mbeturinave në kontejner ju vihet edhe zjarri. Në momentin e vizitës takuam personelin e çerdhes duke hedhur mbeturinat e fëmijëve (ushqime të mbetura, pampersë, dyshekë të lagur) po në të njëjtit kontejner, pasi vet objekti parashkollor nuk posedonte kontejnerët vetanak për eliminimin e mbeturinave.”

26. Avokati i Popullit, mbi bazën e gjetjeve dhe vlerësimeve të raportit të IKShPK-së, vlerëson se gjendja e pasqyruar paraqet mjaftueshëm situatë shqetësuese për mirëqenien dhe shëndetin e banorëve dhe në veçanti të fëmijëve, të cilët qëndrojnë në kopshtin në afërsi.
27. Për më tepër, Avokati i Popullit sjell në vëmendje se ndotja e ajrit nga mbeturinat dhe djegia e tyre ka pasoja të shumta për shëndetin publik dhe menaxhimi jo i duhur i tyre ndikon ekskluzivisht në cilësinë e jetës së qytetarëve. Posaçërisht duhet theksuar se ekspozimi apo afërsia e fëmijëve me mbeturinat është shqetësim serioz, për faktin se fëmijët janë më të ndjeshëm për nga aspekti shëndetësor ndaj ndotjes së ajrit. Djegia e mbeturinave në mënyrë të pakontrolluar përbën rrezik serioz për shëndetin e njeriut, si fakte të vërtetuara shkencërisht nga Organizata Botërore e Shëndetësisë.
28. Efektet e mundshme shëndetësore të vlerësuara nga IKShPK-ja, mbi bazën e gjendjes si pasojë e ekspozimit ndaj mbeturinave, janë, por nuk kufizohen, si vijon: “*Rrezik potencial për shëndetin e punëtorëve të cilët manipulojnë me mbeturina; Rrezik potencial për banorët me që mbeturinat janë terren i përshtatshëm për rritjen dhe shumëzimin e insekteve dhe brejtësve, që shërbejnë si vektor për bartjen e sëmundje të ndryshme ngjitëse; Rrezik potencial për sulm nga qentë dhe macet endacake, të cilat kërkojnë ushqim nga mbeturinat përreth kontejnerëve; Qentë dhe macet endacake bëjnë shpërndarjen e mbeturinave që përsëri rritë rrezikun për sëmundje ngjitëse; Prezenca e qenve dhe maceve endacake potencialisht rritë nivelin e zhurmës në lagje. Rrezik potencial nga lëndimet mekanike (xhamat, gjësendet me tehe dhe maje) të cilat gjinden në mbeturinat rreth kontejnerëve, posaçërisht për fëmijët të cilët lozin në parkun pranë mbeturinave si dhe për personat që grumbullojnë mbeturina të riciklueshme; Rrezik potencial për fëmijët që lozin në parkun e lodrave pranë, për shkak të gjërave të cekura më lartë; Kapakët e kontejnerëve janë të hapura dhe i nënshtrohen kushteve. Klimatike; Aroma e pakëndshme e mbeturinave, gjithherë është e pranishme.; Ndezja e kontejnerëve ndikon edhe më shumë cilësinë e ajrit.”*
29. Avokati i Popullit shpreh shqetësimin lidhur me rreziqet potenciale shëndetësore të vlerësuara në raportin e IKShPK-së, si pasojë e ekspozimit të qytetarëve ndaj mbeturinave, me theks të veçantë të gjendjes aktuale pranë banesës së ankuesit, dhe vlerëson se të njëjtat paraqesin gjendje alarmante për mirëqenien e qytetarëve dhe nevojë urgjente për veprim nga autoriteti kompetent. Në rastin *Di Sarno dhe të tjerët kundër Italisë*, GjEDNj-ja theksoi se si pasojë e keqmenaxhimit në komunën ku ankuesit jetonin, mbeturinat nuk ishin mbledhur, ato kishin mbetur në rrugë për disa muaj. Gjykatën konstatoi se dëmi mjedisor për të cilin ata ankoheshin kishte qenë i tillë sa ndikonte drejtpërdrejt në mirëqenien e tyre personale.

30. IKShPK-ja, duke u bazuar në gjetjet në terren dhe në vlerësimin e gjendjes, nëpërmjet raportit përkatës ka rekomanduar si vijon:

- *“Komuna e Prishtinës të ndërrojë lokacionin e kontejnerëve në një vend tjetër pasi, grumbullimi jo i drejtë i mbeturinave urbane përveç që ndikon negativisht në estetikën dhe peizazhin e një rruge, lagjeje apo vendbanimi padyshim se edhe ulë cilësinë e jetës për banim në atë zonë dhe rrezikon seriozisht ndotjen e mjedisit dhe shëndetin e qytetarëve;*
- *Të shqyrtohet mundësia e distribuimit të kontejnerëve për mbeturina sipas objekteve banesore në lagjeve, për çerdhen publike dhe bizneset pranë;*
- *Të bëhet largimi i rregullt i mbeturinave në atë lagje;*
- *Të bëhet funksionalizimi i kapakëve të kontejnerëve të mbeturinave;*
- *Të bëhet pastrimi i rregullt i hapësirës përreth kontejnerëve të mbeturinave;*
- *Të rregullohet hedhja e mbetjeve inerte të cilat kompania për largim të mbeturinave "Pastrimi" nuk i merr;*
- *Të ndalohet hedhja e materialeve ndërtimore dhe të ngjashme në ambientet e destinuara për mbeturina urbane dhe për këtë qëllim në secilën pikë grumbulluese të shkruhet se ndalohet hedhja e tyre;*
- *Të largohen kontejnerët nga afërsia e parkut të lodrave për fëmijë.”*

Konstatimet e Avokatit të Popullit

31. Avokati i Popullit, në rastin konkret, duke u bazuar në të gjeturat e paraqitura në këtë Raport, si dhe analizimit të standardeve ligjore vendore dhe ndërkombëtare, përfshirë praktikën gjyqësore të GjEDNj-së, konstaton se organet kompetente komunale nuk kanë arritur për t'i përmbushur obligimet e tyre pozitive për ndërmarrjen e masave të arsyeshme dhe të përshtatshme për ta respektuar të drejtën e qytetarëve, në rastin konkret të familjes Xharra për një mjedis të shëndetshëm dhe të sigurtë, të garantuar me nenin 52 të Kushtetutës.

32. Për më tepër, Avokati i Popullit vlerëson se efektet e keqmenaxhimit dhe ndikimi i dëmit mjedisor nga mbeturinat dhe kundërmimi i tyre, të vërtetuara edhe nëpërmjet Raportit të IKShP-së kanë ndikuar drejtpërdrejt në mirëqenien personale të familjes së tij, dhe në përgjithësi të banorëve duke cenuar të drejtën në jetën private dhe familjare së banorëve të garantuar me nenin 36 të Kushtetutës [E Drejta e Privatësisë].

33. Raporti vë në dukje se menaxhimi i mbeturinave komunale në lagjen e ankuesit, përkatësisht në rrugën rr. “Afrim Loxha” 3/1, në Prishtinë, nuk është realizuar në përputhje me detyrimet ligjore të theksuara më sipër. Komuna e Prishtinës, në këtë rast, dëshmon se ende nuk ka arritur ta krijojë një sistem të qëndrueshëm për menaxhimin e mbeturinave komunale në të gjitha pikat përkatëse në kryeqytet, si dhe standard me të cilin do ta respektonte të drejtën për mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm si dhe privatësinë e qytetarëve.

34. Avokati i Popullit vlerëson se menaxhimi evidentuar në rastin konkret i mbeturinave nuk i kontribuon parimit ligjor për parandalimin e ndikimit negativ të mbeturinave në mjedis dhe në shëndetin e njeriut, ashtu si parashihet në nenin 22 të Ligji nr. 04/L-060 për

Mbeturina, i cili në paragrafin 1 shprehimisht përcakton: “*Menaxhimi i mbeturinave organizohet në atë mënyrë që mos të paraqiten dëme dhe rreziqe për mjedisin dhe shëndetin e njeriut [...].*”

35. Avokati i Popullit konstaton se, pavarësisht argumenteve të qëndrueshme të ankuesit, të cilat ia kishte adresuar Komunës së Prishtinës për marrjen e masave efektive për mënjanimin e ndikimit negativ të mbeturinave të banorët, Komuna e Prishtinës nuk kishte arritur ta respektonte obligimin kushtetues dhe ligjor për t’u siguruar banorëve një zgjidhje efektive lidhur me shqetësimin të cilin e kishin adresuar.
36. Avokati i Popullit konstaton se ndotja e ajrit, përfshi ndotjen nga lirimimi i kundërmimit të mbeturinave komunale përbën rrezikshmëri për shëndetin e individëve. Ndikimi negativ i ndotjes së ajrit, përfshirë ndotjen nga mbeturinat në shëndetin e njeriut, është vërtetuar nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Referuar standardeve ndërkombëtare dhe praktikës gjyqësore të GjEDNj-së, jetesa e qytetarëve në një mjedis me nivele të larta të ndotjes së ajrit dhe të mjedisit cenon të drejtat e njeriut për një mjedis të sigurt dhe të shëndetshëm si dhe përbën cenim të jetës private dhe familjare dhe të mirëqenies së tyre personale.
37. Avokati i Popullit konstaton se afërsia e fëmijëve me vendet e mbajtjes së mbeturinave, sidomos kur të njëjtat derdhen në mënyra të pakategorizuara dhe të pakontrolluara, përbën shqetësim serioz për shëndetin dhe mirëqenien e fëmijëve. Prandaj marrja e masave nga komuna për këtë rast duhet të jetë prioritet.

Duke u bazuar në rrethanat e cekura më lart, Avokati i Popullit, në pajtim me nenin 135, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës: “[...] *ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa, nëse vëren shkelje të drejtave dhe lirive të njeriut nga ana e organeve të administratës publike dhe organeve të tjera shtetërore.*”; si dhe bazuar në analizën ligjore të mësipërme, në cilësinë e rekomanduesit, duke iu referuar argumenteve të lartpërmendura, me qëllim të përmirësimit të punës në sistemin administrativ të Kosovës, i


REKOMANDON

Komunës së Prishtinës:

- *Në pajtim me kompetencat dhe autorizimet ligjore, t’i ndërmarrë veprimet e nevojshme me efekt të menjëhershëm për menaxhimin e duhur të mbeturinave komunale në rrugën “Afrim Loxha” 3/1, në Prishtinë.*
- *Të veprojë në pajtim me rekomandimet e IKShPK-së.*
- *Deri në periudhën kur mbeturinat të menaxhohen dhe hidhen në mënyrë të klasifikuar, të përkujdeset që kontejnerët aktualë të posedojnë sistem të mbylljes, dhe të mirëmbahen zonat përreth.*

Në pajtim me nenin 132, paragrafi 3, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (“*Çdo organ, institucion ose autoritet tjetër, që ushtron pushtet legjitim në Republikën e Kosovës, është i detyruar t’u përgjigjet kërkesave të Avokatit të Popullit dhe t’i paraqesë atij/asaj të gjitha dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.*”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“*Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të*

dokumentet dhe informacionet e kërkuara në pajtim me ligj.”) dhe me nenin 28 të Ligjit nr. 05/L-019 për Avokatin e Popullit (“Autoritetet, të cilave Avokati i Popullit u ka drejtuar rekomandim, kërkesë ose propozim për ndërmarrjen e veprimeve konkrete, [...] duhet të përgjigjen brenda afatit tridhjetë (30) ditor. Përgjigja duhet të përmbajë arsyet me shkrim për veprimet e ndërmarra lidhur me çështjen në fjalë.”), ju lutemi të na informoni për veprimet që do t’i ndërmerri lidhur me këtë çështje.

Me nderime,

Naim Qelaj

Avokat i Popullit